



REPUBLIKA E KOSOVËS  
 REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
 KOMUNA E OBILIQIT  
 OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ  
 Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq  
**E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, e mbajtur me dt.24.05.2024, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Florije Jashari (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Valon Svirca (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Bajram Hashani (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic (SL).

**Të pranishmit tjerë:** Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, drejtorët komunal, Burim Gërguri, shef i kabinetit të Kryetarit, Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun dhe përf. e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

**R E N D D I T E**

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Strategjisë së komunikimit dhe qasjes 2024 – 2026 për dhënien në debat publik
4. Shqyrtimi i kërkesave
4. Të ndryshme

**Kryesuesja** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 21 vota për.

**Pika 1 e rendit të ditës**

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

**Pika 2 e rendit të ditës**

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 20 vota për.

**Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti shqyrtimin e Strategjisë së komunikimit dhe qasjes 2024 – 2026 për dhënien në debat publik.

**Enver Gashi** – Ne si grup parlamentar jemi për atë që kjo Strategji të kaloj në debat publik, pastaj edhe si qytetarë dhe anëtarë të Kuvendit kemi mundësi me dhënë kontributin që do ta japim dhe në fund kur vjen në Kuvendi e përmbyllim.

**Sami Ahmeti** – Ashtu, siç e cekëm edhe në mbledhjen e KPF-së, ne jemi dakord që ky dokument të shkoj në debat publik, pastaj ti shohim mundësitë tona për të kontribuar në drejtim të saj.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 21 vota për e aprovuan Vendimin për dhënien në debat publik të Strategjisë së komunikimit dhe qasjes 2024 – 2026.

#### **Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Asnjë kërkesë nuk kemi pasë as nga KPF-ja, që kishte me iu rekomandue Kuvendit Komunal për shqyrtim, prandaj kalojmë në pikën e radhës.

#### **Pika 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga Bashkësia islame për shqyrtimin dhe miratimin e ngritjes së çmimeve për shërbimet e varrimit. Ne e kemi vendimin për shërbimet e varrimit që është i vitit 2014 në bazë të cilit është punuar deri më tani dhe shuma ka qenë prej 235 €, ndërsa propozimi i Drejtorisë së financave është 305 €.

**Enver Gashi** – Ne nuk jemi për atë që mos me iu dalë në ndihmë sepse kjo ndihmë nuk është e Bashkësisë islame, por është ndihmë për qytetarët tonë dhe e kuptojmë se kanë ndryshuar çmimet prej vitit 2014 në 2024 që janë 10 vite. Mirëpo, nuk e di qysh i kemi punët me buxhet dhe nëse, ka buxhet jemi për aprovimin e kësaj kërkesë.

**Sami Ahmeti** – Kryesuese, pasi që e lexove kërkesën i dhe shpjegimet që do të duhej të ishin edhe në kërkesë. Ne jemi dakord duke pasë parasysh se Bashkësia islame nuk ka vijë buxhetore që merrë nga institucionet shtetërore. Në këtë rast Komuna ka ndihmuar në këtë drejtim për këtë kategori që secilit prej qytetarëve, apo secilës familje mundet me i ndodhë. Mirë që u shpjegue me shpresën që shuma e caktuar prej 305 euro i mbulon të gjitha këto dhe normal nëse, ka mundësi të ndahet buxhet i tillë ne jemi dakord që të bëhet ky ndryshim.

**Ajet Berisha** – Sinqerisht gati e pakuptueshme kërkesa e Bashkësisë islame, thotë nuk po na mjaftojnë mjetet dhe minimalisht nuk tregojnë sa është dashtë me qenë ato mjete, do të thotë krejtë e pakuptimtë. Ndërsa, delë në anën tjetër thotë Drejtorja e financave e ka caktue njëfarë çmimi, do të thotë është mjaft e pakuptimtë edhe për vendimin që ne po detyrohemi me thënë po ose jo, edhe po e dijmë se ky është vendim në drejtim të qytetarëve, e jo të Bashkësisë islame apo diçka tjetër. Ata kur e kanë arsyetimin se këto mjete nuk po e mbulojnë më këtë punë kishte me qenë mirë me dalë me sugjerimin se ky është çmimi i përafërt që e mbulon këtë punë, e jo ti mbetet Drejtorisë sepse kjo po delë se është 50 % ngritje përafërsisht. Minimalisht nuk patëm një arsyetim të tillë nga ajo çka lexove.

**Kryesuesja** – Kërkoj falje se është edhe çmimorja në fund të kërkesës si në vijim: pastrimi i kufomës 50 €, dërrasa 50 €, qefini 50 €, vendpastrimi i kufomës 40 €, shërbimi i imamit 35 €, transporti i kufomës 70 €, piramida me shkronja 40 €, kështu që totali i shërbimeve të varrimit është 335 €, Pas përfundimit të mbledhjes kërkesën do të ua dërgojmë në email.

**Ajet Berisha** – Edhe një element është tash, pas kësaj çmimoreje edhe një nervozë shtesë është qysh mundet me qenë secili çmim fiks 50, 40, 50 dhe 70 €, sepse jo nuk është njëfarë analize hajt se kaq taman po më bjen, diqysh nuk po jemi nikoqir ndaj pares tonë. Në Komunën e Obiliqit 70 €, transporti për kufomën për mua është shtrenjtë hiç tjerat, sepse disa edhe nuk po i kuptoj. Prapë më duket shtrenjtë 50 €, qefini dhe ata a janë komunitet i joni, a janë pjesë e jona, a janë vëllezër, motra tona ajo Bashkësi islame, a jemi vetë ne. Të gjitha vendimet që po i marrim në vendin tonë pse po duhet hajt të ia lëshoj 10 €, bile Bashkësia islame nuk është dashtë këtë me bë hajt të ia lëshoj 10 €, të më nbeten. Ndoshta, hiç nuk mbeten jam krejtë gabim që kërkoj falje, por mënyra qysh e kanë bërë mua po më dërgon në atë drejtim hajt le të më mbesin këtu, afër 10 €.

**Xhelal Krasniqi** – Sa i përket transportit dhe temave që u ngritën mendoj se kur kemi qenë të prekur me raste të tilla kemi parë se nga morgu i Prishtinës deri në Obiliq, ti merrë 50-60 €. Ndërsa, këtu është fjala me marrë kufomën me dërgue me pastru, me kthye te shtëpia dhe prapë me dërgue te varrezat. Pra, një punëtor duhet ta humbë tërë ditën plus shpenzimet tjera. Unë kisha dashur që kjo kërkesë të trajtohet me ndjeshmëri sepse po

flasim për qytetarët tonë, për familjarët tonë dhe nuk po flasim për dikë të cilët realisht janë një domen tjetër dhe shihen një domen tjetër, kështu që mendoj të jemi të ndjeshëm karshi kësaj çështjeje.

**Kryetari** – Ne e kemi trajtue dhe kemi bashkëbisedue edhe me Kryetarin e Bashkësisë islame dhe sinqerisht ky është një shërbim që të gjithë e kuptojmë që është për qytetarët, bile është një shërbim jo i pritshëm në momentet kur ndodhin ndarjet fizike me anëtarët e familjes dhe normal don organizim që ndodhë në jetën e përditshme njerëzit parapërgatiten. Ndërsa, kjo nëse kish me shërbye në shumë pak raste për ata të cilët kanë mundësi me iu gjetë Komuna, në këtë rast mendoj se është edhe akt human. Sa i përket pjesës buxhetore ka mundësi të mbulesës për shumën që e kanë kërkuar.

**Kryesuesja** – Pyeti shumën që e kanë kërkuar apo 305 €.

**Kryetari** – Përgjegjet se sipas llogarisë qenka 335 €, dhe nuk ka ndonjë problem për plotësim të kësaj shume që i bjen dikund rreth 100 €, duke u bazuar që vendimi është i vitit 2014, duke u bazuar në jetën e përditshme që ne po e bëjmë edhe ngritjen e çmimeve në vend.

**Sami Ahmeti** – Të sqarohemi tashmë, i kemi 3 propozime është propozimi i Bashkësisë islame, propozimi i Drejtorisë dhe është propozimi i Kryetarit që në njëfarë mënyre po shkon me propozimin e Bashkësisë islame. Tash, cila do që të prezantohet nga ana jonë e ka mbështetjen.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 18 vota për dhe 3 vota abstenim morën Vendim për plotësim ndryshimin e vendimit nr.-I-13, të dt.26.02.2014 për rregullimin e shërbimeve të varrimit në shumën prej 335 euro, në territorin e Komunës së Obiliqit.

**Shaip Paloja** – Unë e barti një brengë të fshatit se fatkeqësisht në varrezat e fshatit Palaj është vjedhë rrethoja e metalit komplet, fatkeqësisht një diçka që nuk mundesh me marrë me mend se çka ka ndodhë. Tash, nuk e di sa janë mundësitë e Komunës, që me bë atë rrethojë apo me bashkëfinancim, vetëm si pyetje po e paraqesë dhe sa janë mundësitë e Komunës.

**Kryetari** – Ne kemi informacion nëse, nuk gaboj që është hap një rast në polici dhe shërbimet publike janë në proces, kështu që do ta shohim ose nga vija e bashkëfinancimit nëse, do të ketë vullnet edhe nga banorët aty, ose nga shërbimet komunale mund ta mbulojnë këtë çështje.

**Ajet Berisha** – Meqë, është Kryetari po e shfrytëzoj mundësinë me pyet dhe me marrë informatë mundësisht. Në vitin 2018 është nisë një sërë takimesh informuese për me pa mundësinë me u rrëzue kjo shkolla këtu dhe u bënë 6 vite nga atëherë jo në këtë vit, jo në atë vit, Tash, a bën me ditë një arsye pse po ekziston kjo shkollë këtu, pse nuk po rrënohet. Ata nxënësa 10 ose 15 sa vijnë sikur në mënyrë kriminale i detyrojnë me ardhë këtu dhe i paguajnë atëherë, e kemi pasë informatën kur shkolla është në Plemetin. Ata nxënësa pse vijnë këtu, pse nuk rrënohet kjo shkollë, ky objekt i vjetër që edhe me plan kemi thënë se kjo duhet të hiqet me u bë ose parking ose hapësirë të cilën kanë me shfrytëzue Komuna dhe shkolla. Unë nuk e shohë asnjë logjikë prej vitit 2018 mos me u marrë ky vendim dhe me ekzistue ky objekt i shëmtuar.

**Kryetari** – Ju e dini se në planifikimin e këtij buxheti të këtij viti është paraparë edhe rrënimi i qendrës tregtare, kafiterive që po i thotë dikush që është në proces dhe besoj se shumë shpejtë do të filloj rrënimi i kafiterive dhe shëndrrimi në një park. Po ashtu, në projekt buxhet e kemi edhe rrënimin e shkollës dhe ndërtimin e një parkingu që do të jetë në shërbim të qytetarëve. Pra, të dyja janë në procedura dhe nuk është rrënuar më heret ndoshta për shkak të mundësive buxhetore dhe për shkak të rrethanave politike. Ju e dini se menaxhimet bëhen nga niveli qendror si dhe janë pak situata më të komplikuar duke u nisë nga qendra që e përmenda për kafiteritë është nisë procedurë gjyqësore. Pastaj, ka dalë eksperti në vendin e ngjarjes duke e shikue gjendjen faktike, është dashur të nxjerret çmimi dhe është dashur një ekspertë të vlerëson qëndrueshmërinë e betonit. Tani, jemi në përmbyllje që është paralajmërimi i të gjithë atyre që kanë kontrata për shpronësim, që deri më tani janë lajmëruar 4 nëse, nuk gaboj që i kanë sjellë dhe janë të vërtetuara nga Gjykata. Ndërsa, pjesa tjetër ekzekutimin e rrënitimit nuk do ta ndaloj dhe varësisht prej zhvillimeve që ata e sjellin të dëshmuar nga Gjykata, vendimet ato do të paguhen në bazë të çmimit që vetë Gjykata e ka nxjerrë në vendngjarje.

**Sami Ahmeti** – Duke qenë se jemi në fund të vitit shkollor dhe një informatë që na ka ardhë prej policisë dhe fëmijëve tonë për rastin para 2 dite, që ka ndodhë me nxënësit tonë në Prizren me ç' rast janë plagosë 2,3 nxënës nga rrahjet me mjete të forta dhe armë të ftohta. Unë kisha pasë dëshirë me ngritë si temë, e jo si një përfaqësues

politik, por në fakt si një prind dhe me pasë një reflektim që në organizimet e tilla të kemi shumë kujdes. Sigurisht se jeni të informuar për rastin që ka ndodhë dhe a është e vërtetë se DKA-ja, i udhëzon kujdestarët e klasave, kryesisht të 9-ta, që fëmijët ti orientojnë në një mbrëmje të semi maturës të një biznesi i caktuar. Unë kam me shkrim grupe të prindërve, që shkruan se DKA-ja po na këshillon, po na bën presion që fëmijët me i dërgue të x biznesi, të x restoranti. Unë kam dëshirë me ditë Kryetar se a e dini ju këtë punë sepse kjo nuk është në rregullë, por te e para jam në gjendje që të gjitha kapacitetet tona me i ngritë që me pasë qoftë ndonjë tryezë të rrumbullakët, qoftë ndonjë debat që me ngritë vetëdijësimin sepse falë zotit nuk ka ndodhë rasti ekstrem që ka mund me qenë me fatalitet. Megjithatë, kanë ndodhë raste shumë të rënda që fëmijët janë traumatizue prej atyre gjërave çka kanë ndodhë. Unë nuk dua me akuzue stafin ose mësimdhënësit përcjellës që kanë qenë me ata sepse kam informata se janë mundue me dhënë maksimumin, por është moshë e cila është vështirë të kontrollohet që do të duhej të involvoheshin besoj edhe prindërit. Sido që të jetë uroj të mos ndodhin rastet e njejta tjetërkund, vetëm ta kemi si informacion dhe si masë që kur bëhen organizime të tilla të llogariten edhe këto raste.

**Kryetari** – Sa i përket rastit të parë është për keqardhje dhe shpresojmë të mos ndodhin më, ndërsa çështja e semi maturës, e mbrëmjes së maturës që 11 vjet si Komunë kurrë nuk jemi përzier në këtë drejtim. Këshilli i prindërve ka përzgjedhë si zakonisht bashkë me mësimdhënësit, është organizim komplet i tyre, që uroj të kalojnë sa më mirë. E kanë përmbyllje të një etape dhe vazhdim të një faze tjetër sido që të themi janë semi maturantë apo maturantë, ata kalojnë në një etapë tjetër dhe të kalojnë sa më mirë. Unë sa e di organizohet prej vetë shkollave dhe prej Këshillit të prindërve.

**Mbledhja përfundoi në ora 11:33'**

**Bashk.prof.për punë të KK**

  
Azize Zeneli

**Kryesuesja e Kuvendit Komunal**

  
Vlora Mjekiqi Kabashi





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E OBILIQ - OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 01-060-01-17245-24

Nr. i fq. / Br. str. / No. pp.

Data / Datum / Date 18.06.2024

OBILIQ - OBILIČ - OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OF OBILIC



## KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilič - Municipality Assembly Obiliq

### IZVOD IZ ZAPISNIKA

Sa sednice Skupštine opštine, održane 24.05.2024.godine, u 11:00 časova, u sali Skupštine opštine.

Prisutni članovi SO: Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Florije Jashari (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Valon Svirca (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Bajram Hashani (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristić (SL) i Biljana Spasić (SL).

**Ostali prisutni:** Xhafer Gashi, Gradonačelnik opštine, opštinski direktori, Burim Gerguri, šef kabineta gradonačelnika, Festina Preniqi, službenik za odnose sa javnošću i predstavnici. KFOR-a.

Sastanak je vodila Vlora Mjekiqi Kabashi, predsedavajuća koja nakon što je utvrdila da postoji kvorum, započela sastanak sa sledećim:

### DNEVNIM REDOM

1. Opravdanje za odsustvo
2. Usvajanje izvoda iz zapisnika sa prethodnog sastanka
3. Pregled strategije komunikacije i pristupa za 2024-2026 za javnu raspravu
4. Razmatranje zahteva
4. Razno

**Presedavajuća** - Upoznala je prisutne sa dnevnim redom koji je usvojen jednoglasno.

#### Tačka 1. dnevnog reda

Svi članovi SO su bili prisutni.

#### Tačka 2. dnevnog reda

Izvod iz zapisnika sa prethodne sednice usvojen je sa 20 glasova.

#### Tačka 3. dnevnog reda

Presedavajući – Predstavila pregled Strategije komunikacije i pristupa za 2024-2026 za javnu raspravu.

**Enver Gashi** – Mi kao poslanička grupa smo za to da se ova Strategija daje u javnu raspravu, zatim i kao građani i poslanici imamo priliku da damo doprinos na kraju, kada je Skupština u pitanju.

**Sami Ahmeti** – Dakle, kao što smo napomenuli na sastanku KPF-a, slažemo se da ovaj dokument ide na javnu raspravu, a onda ćemo videti naše mogućnosti da tome doprinesemo.

Odbornici Skupštine opštine sa 21 glasova usvojili su Odluku o javnoj raspravi o Strategiji komuniciranja i pristupa 2024-2026.

#### Tačka 4. dnevnog reda

**Presedavajuća** - Ni u KPF nismo dobili nijedan zahtev, koji je predložen Skupštini opštine na razmatranje, tako da prelazimo na sledeću tačku.

## **Tačka 5. dnevnog reda**

**Predsjedavajuća** - Iznela je zahtev Islamske zajednice za preispitivanje i odobrenje povećanja ceena pogrebnih usluga koje je iz 2014. godine, na osnovu koje smo do sada radili i iznos je bio 235. evra, dok je predlog Direkcije za finansije 305 evra.

**Enver Gashi** – Nismo za to da im ne možemo pomoći jer ova pomoć nije za Islamsku zajednicu, već je pomoć našim građanima. Razumemo da su se cene menjale od 2014. do 2024. godine, ali ne znam koliko smo planirali i ako postoji budžet, mi smo za to da se ovaj zahtev odobri.

**Sami Ahmeti**– Predsedavajuća, posto ste pročitali zahtev i objašnjenja koja takođe treba da budu u zahtevu. Slažemo se s obzirom da Islamska zajednica nema budžetsku liniju koju dobija od državnih institucija. U ovom slučaju, Opština je pomogla u ovom pravcu za ovu kategoriju koja se može desiti svakom od građana ili svakoj porodici. Dobro je što je to objašnjeno u nadi da fiksni iznos od 305 evra pokriva sve troškove pogrebnih usluga, a normalno ako je moguće izdvojiti takav budžet, slažemo se da tu izmenu treba izvršiti.

**Ajet Berisha** – Iskreno rečeno, zahtev Islamske zajednice je skoro neshvatljiv, kaže da nemamo dovoljno sredstava i da bar ne pokazuju koliko bi ta sredstva trebalo da budu, znači potpuno besmislena. Dok, s druge strane, stoji da je Direkcija za finansije odredila cenu, to znači da je prilično besmisleno čak i za odluku da smo prinuđeni da kažemo da ili ne, iako znamo da je to odluka u pravcu građana a ne Islamske zajednice ili nešto treće. Kada imaju opravdanje da ova sredstva više ne pokrivaju ovaj posao, bilo bi bolje da iznesu sugestiju da je to okvirna cena koja pokriva ovaj posao, a ne za Direkciju, jer ispada da je ovo povećanje od oko 50%. Bar mi nismo imali takav utisak iz onoga što ste pročitali.

**Predsedavajuća** – Izvinjavam ali zahtevu su priložene i sledeće cene: čišćenje leša 50 evra, daska 50 evra, pokrov 50 evra, čišćenje leša 40 evra, usluga imama 35 evra, prevoz leša 70 evra, piramida sa pismom 40 evra, dakle ukupno pogrebne usluge 335 evra.

**Ajet Berisha** – Ima još jedan element, posle ove cene, dodatna nervoza je kako svaka fiksna cena može da bude 50, 40, 50 i 70 evra, jer ne, nije neka analiza. U opštini Obilić mi je skupo 70 evra za transport leša, ostale sklonite jer neke ni ne razumem. Još mi je 50 evra skupo za pokrov i da li su oni naša zajednica, da li su oni deo nas, da li su to naša braća, sestre.

**Xhelal Krasniqi** – Što se tiče transporta i tema koje su pokrenute, mislim da kada smo bili pogođeni ovakvim slučajevima, videli smo da od prištinske mrtvačnice do Obilića treba 50-60 evra. A ovde se e leš uzima, šaljeu praonici, vraca se kući i ponovo šalje na groblje. Dakle, radnik mora po tu cenu ceo dan da radi plus ostali troškovi. Želeo sam da se ovaj zahtev tretira sa senzitivnošću jer govorimo o našim građanima, članovima naše porodice.

**Gradonačelnik** – Mi smo se time bavili i razgovarali sa predsednikom Islamske zajednice i iskreno, ovo je usluga za koju svi razumemo da je za građane, neočekivana usluga u trenucima kada dođe do fizičkih razdvajanja sa članovima porodice. Opština se našla u ovom slučaju, mislim da je to i human čin. Što se tiče budžetskog dela, postoji mogućnost da se pokrije iznos koji je zatražen.

**Predsedavajuća** – iznos koji je zatražen ili 305 evra.

**Gradonačelnik** – Odgovara da je po računu 335 i nema problema da se ispuni ovaj iznos koji je negde oko 110 evra s obzirom da je odluka iz 2014. godine, a na osnovu svakodnevnog života kojim ima i povećanje lokalnih cena.

**Sami Ahmeti** – Da sad razjasnimo, imamo 3 predloga: predlog Islamske zajednice, predlog Uprave i predlog predsednika, koji nekako ide sa predlogom Islamske zajednice a koji god se predlaže, sa naše strane bice podrzan.

Nakon održane rasprave, odbornici Skupštine opštine sa 18 glasova za i 3 uzdržana usvojili odluku da se izvrši izmena odluke br.-I-13 od 26.02.2014.godine za pokrivanje pogrebnih usluga po racunu 335 na teritoriji opštine. Obilić.

**Shaip Paloja** – Iznosim zabrinutost sela da je nažalost na groblju u selu Crkvena Vodica ukradena kompletna metalna ograda. E sad, ne znam kakve su mogućnosti Opštine, da li ograda se može napraviti sa sufinsansiranjem, i koje su mogućnosti Opštine.

**Gradonačelnik** – Imamo informaciju i prijavljen je slučaj u policiji i javne službe su u toku, pa ćemo videti ili sa linije sufinansiranja da li će biti volje tamošnjih stanovnika, ili iz opštinskih službi možemo pokriti ovo pitanje.

**Ajet Berisha** – Pošto je predsednik prisutan, koristim priliku da ga pitam i da se informišem ako je moguće. U 2018. godini započeta je serija informativnih sastanaka za rušenje stare škole i od tada je prošlo 6 godina, da li postoji razlog zašto ova škola postoji? zašto se ne rusi? 10-15 đaka dođu kao da su krivično prinudeni da dođu ovde i placamo ih, imamo podatak kada je škola u Plemetu. Zašto ti đaci dolaze ovde, zašto nije srušena ova škola, ova stara zgrada koju i planom koji smo rekli treba da se ukloni i da postane parking ili prostor koji Opština i škola koriste. Ne vidim nikakvu logiku u 2018. zašto ne bi trebalo da se donese ova odluka i da postoji ovaj ružni objekat.

**Gradonačelnik** – Vi znate da je planiranjem ovogodišnjeg budžeta predviđeno rušenje tržnog centra, a verujem da će rušenje kafića i pretvaranje u park. će početi vrlo brzo. Takođe, u budžetskom projektu imamo rušenje škole i izgradnju parkinga koji će biti na usluzi građanima. Dakle, oba su u procesu i nije ranije srušena verovatno zbog budžetskih mogućnosti i zbog političkih okolnosti. Znate da se upravljanje radi sa centralnog nivoa, a ima još nekoliko komplikovanih situacija, počev od tržnog centra koje sam pomenuo, pokrenut je sudski postupak, onda je veštak izašao na lice mesta, pogledao stvarno stanje, onda je trebalo odrediti cenu, bilo je potrebno da stručnjak proceni trajnost betona. Sada smo u zaključku, a to je upozorenje svima koji imaju ugovore o eksproprijaciji, koji su do sada obavesteni, doneli su i overene dokumente od suda. Dok ostatak neće zaustaviti izvršenje rušenja, a u zavisnosti od razvoja događaja koji budu izneli kao svedoci Sudu, odluke će biti plaćene po ceni koju je sam Sud doneo na licu mesta.

**Sami Ahmeti** – S obzirom da smo na kraju školske godine i dobili smo informaciju od policije i naše dece o slučaju od pre 2 dana koji se desio incident našim učenicima u Prizrenu, u kojem je 2,3 učenika povređeno od batiranja jakim oruđem i hladnim oružjem. Želim to pokrenem kao temu, ne kao politički predstavnik, nego zapravo kao roditelj i imao sam promišljanje da takve organizacije treba da budu veoma oprezne. Naravno, obavesteni ste o slučaju koji se desio i da li je tačno da DKA nalaže razrednim straesinama, uglavnom 9 razreda da na polumaturskoj večeri orijentišu decu na određeni biznis. Dobio sam obevestenje od grupe roditelja, koji pišu da nas DKA savetuje, vrši pritisak da šaljemo decu u iks biznisu, iks restoranu. Predsedniče, da li znate ovaj problem jer ovo nije u redu, pre svega ja sam u stanju da sakupimo sve naše kapacitete za okrugli sto, bilo kakvu debatu koja budi svest jer hvala Bogu nije imao ekstreman zavrsetak koji je mogao biti fatalan. Međutim, bilo je veoma ozbiljnih slučajeva gde su deca bila traumatizovana stvarima koje su doživeli. Ne želim da optužujem osoblje ili nastavnike koji su bili sa njima jer imam saznanja da su se trudili da daju sve od sebe, ali to je doba koje je teško kontrolisati i verujem da treba da se uključe i roditelji. U svakom slučaju, voleo bih da se isti slučajevi ne dešavaju drugde, samo da to bude informacija i kao mera da kada se naprave takve organizacije i ta pitanja budu uračunata.

**Gradonačelnik** – Što se tiče prvog slučaja, to je žalosno i nadamo se da se neće ponoviti, dok se pitanje mature, maturalne večeri, 11 godina kao Opština, nikada nismo se mešali u ovom pravcu. Savet roditelja odabrao je, kao i obično, zajedno sa nastavnicima, njihovu kompletnu organizaciju, za koju želim da prođe što bolje. Imaju zavrsetak jedne etape i nastavak druge etape, bez obzira da li su poludiplomci ili maturanti, prelaze u drugu fazu i prolaze najbolje što mogu. Koliko znam, organizuju ga same škole i Savet roditelja.

Sastanak je završen u 11:33'sati.

Stručno lice za posao SO

  
Azize Zeneli

Presedavajuća Skupštine opštine

  
Vlora Mjekiqi Kabashi